

**VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**  
**"DITEKO" Sh.p.k**

Sot në Tiranë më datën **01.08.2023** në selinë e saj Rruga "Donika Kastrioti", Nr. 4, Tiranë, u mbledh Asambleja e shoqërisë "DITEKO" Sh.p.k e thirrur nga Administratori i shoqërisë z. Shkelqim Golli.

Rendi i ditës i mbledhjes është:

- **Shqyrtimin e "Raport Zmadhim Kapitali" mbi pasqyrat financiare të përgatitura për qëllim të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë "DITEKO" shpk, përgatitur nga Audituesi Ligjor, z. Elton Tirana.**

Në mbledhje morën pjesë ortakët e shoqërisë:

- 1- Shoqëria "GJOKA KONSTRUKSION" SHA** e cila është zotëruese e 1 kuote me 50% të vlerës së kapitalit të shoqërisë DITEKO SHPK, përfaqësuar nga administratori i saj Z. Rrok Gjoka (Aksionar i vetëm i shoqërisë "GJOKA KONSTRUKSION" SHA)
- 2- Shoqëria "ME-AJ ENERGY" SHPK**, e cila është zotëruese e 1 kuote me 35% të vlerës së kapitalit të shoqërisë DITEKO SHPK, përfaqësuar nga administratori i saj Z. Përparim Golli (Ortak 50% i shoqërisë "ME-AJ ENERGY" SHPK)
- 3- Shoqëria "2T" SHPK**, e cila është zotëruese e 1 kuote me 10% të vlerës së kapitalit të shoqërisë DITEKO SHPK, përfaqësuar nga administratori Z. Artan Sako (Ortak 50% i shoqërisë "2T" SHPK)
- 4- Shoqëria "PERXHOLA" SHPK**, e cila është zotëruese e 1 kuote me 5% të vlerës së kapitalit të shoqërisë DITEKO SHPK, përfaqësuar nga administratori Z. Përparim Golli (Ortak i vetëm i shoqërisë "PERXHOLA" SHPK).

Meqënëse ekziston kuorumi i nevojshëm për marrjen e vendimeve të vlefshme sic parashikohet në nenin 86 të ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", pas shqyrtimit të dokumentacionit shoqëruar, Asambleja e Përgjithshme

**VENDOSI:**

- 1- Miratimin e "Raport Zmadhim Kapitali" mbi pasqyrat financiare të përgatitura për qëllim të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë "DITEKO" shpk, përgatitur nga Audituesi Ligjor, z. Elton Tirana.

- 2- Zmadhimin e Kapitalit të Nënshkruar të Shoqërisë me shumën neto 173,664,000 Lekë, që do të cojë Kapitalin e Nënshkruar të Shoqërisë në vlerën përfundimtare 551,430,000 Lekë.
- 3- Rezervat e Tjera të Shoqërisë nga vlera e 807,129,027 (tetëqind e shtatë milion e njëqind e njëzetë e nëntë mijë e njëzet e shtatë) Lekë pas zmadhimit shkon në vlerën 807,129,684 (tetëqind e shtatë milion e njëqind e njëzetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjet e katër) Lekë
- 4- Depozitimim e këtij Vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

#### ORTAKËT E SHOQËRISË

##### "GJOKA KONSTRUKSION" SHA

Rrok Gjoka



##### "2 T" SHPK

Artan Sako



##### "ME-AJ ENERGY" SHPK

Përparim Golli



##### "PERXHOLA" SHPK

Përparim Golli

